



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**ADGJA.nr.03/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën të parashtruar nga Sh.H. nga M..., kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë AD.GJTHM.nr.1/24 të datës 07.05.2024, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, më datë 17.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e parashtruar nga Sh.H. nga M..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë AD.GJTHM.nr.1/24, i datës 07.05.2024, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin AD.GJTHM.nr.1/24, i datës 27.03.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën disiplinore të parashtruar nga pala Sh.H. kundër gjyqtarit Xh.I. gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Ndaj Aktvendimit AD.GJTHM.nr.1/24 i datës 27.03.2024, pala ankuese Sh.H., ka parashtruar ankesë me datë 03.04.2024, përmes Gjykatës Themelore në Mitrovicë për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

Gjykata Themelore në Mitrovicë e ka përcjellë ankesën në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e cila ankesë është pranuar me datë 05.04.2024, por e njëjta ankesë është kthyer prap në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në vlerësim sa i përket lejueshmërisë.

Ushtruesi i detyrës i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë me aktvendimin AD.GJTHM.nr.1/24 i datës 07.05.2024, e ka hedhur si të palejuar ankesën e palës Sh.H. nga M... e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, AD.GJTHM.nr.1/24 i datës 27.03.2024

Pala ankuese Sh.H. me datë 13.05.2024, ka parashtruar ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi refuzimin e kërkesës për hüdhen e aktakuzës, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e ankimuar ta anuloj ashtu që këtë çështje ta dërgoj për hetim pranë Zyrës Disiplinore të Këshillit Gjyqësor.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave në lëndë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore konsideron se:

- ankesa e palës Sh.H. është **e pabazuar**

Në ankesë Sh.H. ka theksuar se aktvendimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me dispozitat e KPPK dhe se me të njëjtin i është shkelur e drejta e cila i njihet me Kushtetutë sepse gjyqtari pas kërkesës për përjashtim ka shkelur Kodin e Procedurës Penale përkatësisht nenet 38,39,40,41,42 dhe 43, pikërisht këto nene e përcaktojnë se pas kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit e obligojnë që menjëherë të ndërpresë të gjitha procedurat në drejtim të veprës penale.

Kryetari i Gjykatës së Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e parashtruar është e palejuar dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur kur e ka hedhur ankesën e palës Sh.H. si të palejuar.

Me nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, parashihet se: “*Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoritetet vijuese (në tekstin e mëtejshëm: “Autoriteti Kompetent”)*”. Ndërsa paragrafi 6 i këtij neni shprehimisht parasheh se: “*Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Lidhur me vendimin e marrë, Autoriteti Kompetent njofton menjëherë me shkrim personin që ka paraqitur ankesë. Një kopje e vendimit i dorëzohet edhe Këshillit përkatës, dhe në rastet e parapara me paragrafin 3 të këtij neni edhe Avokatit të Popullit”*.

Sipas Rregullores (05/2019) për procedurën disiplinore të gjyqtarëve në nenin 7 paragrafi 1 parashihet se: “*Pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent mund ankesën ta hüdhe, refuzon, ose të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve.”*

Në rastin konkret Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin AD.GJTHM.nr.1/2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën disiplinore të parashtruar nga pala Sh.H. ndaj gjyqtarit Xh.I.- gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Meqenëse ndaj aktvendimit të tillë nuk është e lejuar ankesa rezulton se ankesa e palës Sh.H. e parashtruar ndaj

aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë AD.GJTHM.nr.1/24 të datës 07.05.2024, është e palejuar sepse me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se në rastet kur autoriteti kompetent e refuzon kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ankuesi mund të parashtrij ankesë ndaj këtij vendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË**  
**ADGJA.nr.03/2024, më datë 17.05.2024**

**Kryetari i Gjykatës**  
**Valon Totaj**